



Planuar / Dorezuar Primitje/Prodato Received/Delivery	30.06	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SK/MSH/IL	3839	2022	116	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.458/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.458/2022 të datës 17.05.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: kundër Vendimit KA.Nr.11/2022 të datës 19.04.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.458/2022 e datës 17.05.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.Nr.11/2022 i datës 19.04.2022 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi, kandidatë për pranim në Shërbimin Civil, më datë 17.05.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2871/2022 të regjistruar nën shenjën A.nr.458/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.Nr.17/2022 të datës 19.04.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkelje të parimit të meritës, keqpërdorim i detyrës zyrtare nga ana e komisionit vlerësues, shkelje e dispozitave ligjore për shërbyesit civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 25.05.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariatit i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa më datë 01.06.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjiture.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2871/2022 të datës 17.05.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër 01/892 të datës 19.04.2022; Ankesën me numër të protokollit 01/705 të datës 04.04.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 3017/2022 të datës 25.05.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 33195/2022 të datës 01.06.2022; Fletë kthesën e datës 20.04.2022; Testin me shkrim të datës 11.03.2022 si dhe testi me gojë së bashku me vlerësimet e anëtareve të komisionit të datës 11.03.2022 të ankuesit; Kërkesën për punësim të ankuesit të datës 28.02.2021 së bashku me dokumentet mbi përvojën e punës dhe përvojën profesionale të ankuesit; Vendimin me Ref.nr.6-1680 të datës 20.03.2018; Propozimin për emërimin të Komisionit përzgjedhës të datës 20.01.2022; Njoftimin me numër 03/672 të datës 29.03.2022 për përzgjedhjes përfundimtare; Propozimin e datës 29.03.2022 për emërimin e kandidatit të rekomanduar; Raportin final të rekomandimit nga komisioni rekrutues të datës 28.03.2022; Renditja përfundimtare e kandidateve të datës 11.03.2022 Form. Map.Shck-10; Renditja përfundimtare e të listës së ngushte Form-MAP-SHCK-10; Përmbledhja e vlerësimeve individuale Form.MAP-SHCK-09; Përcaktimi i kriterëve për testin me shkrim dhe me gojë për vendimin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-07a; Listën me numër 03/518 të datës 17.03.2022 të kandidateve që nuk kanë kaluar testin me shkrim për zyrtar ligjor për gjykatën Themelore në Prizren dhe Ferizaj të mbajtur me datën 11.03.2022; Listën me numër 03/517 të datës 17.03.2022 të kandidateve që kanë kaluar testin me shkrim për zyrtar ligjor Gjykatën Themelore në Prizren dhe Ferizaj të mbajtur me datën 11.03.2022; Raportin e KPSHC-se i punës nga lista e ngushtë për pozitën zyrtar ligjor të datës 08.03.2022; Regjistri i aplikacioneve të pranuar për pozitën Zyrtar Ligjore në Gjykatën Themelore në Ferizaj; Deklaratën mosekzekutimin e konfliktit të interesave të anëtarit të komisionit Deklaratën mosekzekutimin e konfliktit të interesave të anëtarit të komisionit Deklaratën mosekzekutimin e konfliktit të interesave të anëtarit të komisionit Deklaratën mosekzekutimin e konfliktit të interesave të anëtarit të komisionit Përcaktimin e kriterëve për përfshirje në listën e ngushte për pozitën Zyrtar Ligjor në Gjykatën Themelore në Ferizaj Form.MAP-Shack-05; Vendimin me numër Ds062/2022 të datës 20.01.2022; Kërkesën me numër 03/2006 të datës 16.12.2021 të për autorizimin e konkursit të jashtëm me numër 04/2021; Publikimin e konkursit të jashtëm me numër të protokollit 03/2006 të datës 16.12.2021; Emalin e datës 16.12.2021; Emalin datës 21.01.2022; Vlerësimin e Testit me shkrim të datës 11.03.2022 dhe testit me gojë 22.03.2022 të kandidates

Kërkesa për punësim e datës 24.12.2021 të bashkangjitur me dosjen lidhur me përgatitjen profesionale të kandidates Certifikatën me numër GJ.SA.Nr..96/2020 të datës 31.03.2020; Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve nuk është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo Gjykatë; Marrëveshjen me numër 238 të datës 01.04.2021; Certifikatën me numër 3037/16; Certifikatën e datës 07.05.2014; Kontratën punës me numër të protokollit LA-56 të datës 06.07.2020; Diplomën me NO. 775/18 të datës 20.06.2018; Vlerësimin e testit me shkrim të datës 11.03.2022 si dhe vlerësimin e intervistës me gojë të datës 25.03.2022 të kandidatit Kërkesën për punësim të datës 24.12.2021 të kandidatit

se bashku me përgatitjen profesionale; Diplomën me numër 1665/2019 të datës 13.09.2019; Pasqyren e notave të datës 23.09.2019; Certifikatën me numër 118/2021 të datës 02.06.2021; Rekomandimin e datës 02.06.2021; Referencën e datës 02.06.2021; Letrën Rekomanduese lidhur me praktiken në Gjykatën Themelore në Ferizaj; Certifikatën e datës 11.12.2018; Shkresën e datës 10.11.2019; Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve nuk është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë; Vlerësimin e punës së personelit përkatës të datës 02.06.2021; Dokumentin e identifikimit të kandidatit Vërtetimin e datës 08.04.2020; Kontratën e punës të datës 11.02.2021; Vlerësimin e testit me shkrim të datës 11.03.2022 dhe intervistës me gojë të kandidatës Kërkesën për punësim të datës 28.12.2021 si dhe përgatitjen profesionale të kandidatës Certifikatën me numër 238/2021 të datës 29.04.2021; Referencën e datës 09.12.2021; Letër Referencën e datës 04.02.2021; Letër referencën e datës 25.02.2021; Diplomën me Nr.908/19 të datës 25.06.2019; Vendimin me numër 03/76 të datës 22.01.2021; Dokumentin e identifikimit të kandidatës Vlerësimin e testit me shkrim të datës 11.03.2022 dhe intervistës me gojë të datës 25.03.2022 të kandidatit Kërkesën për punësim të datës 22.12.2021 të kandidatit Dokumentin e identifikimit të kandidatit Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve nuk është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë; Diplomën me numër NR. 4387 të datës 13.09.2016; Diplomën me numër Nr. 2094 të datës 06.02.20219; Mirënjohjen e vitit 2016; Certifikatën e datës 29.07.2016; Certifikatën e datës 01.02.2009; Certifikatën me numër 30.10.2008; Vërtetimin me numër reference GJ.A.Nr. 310/2019 të datës 03.09.2019; Vërtetimin me numër GJ.A. Nr.311/20 të datës 30.11.2020; Referencën e datës 09.09.2019; Referencën e datës 30.08.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar**, sepse:

Bazuar në provat e administruara të lëndës është konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 16.12.2021 ka shpallur konkursin me Nr.04/2021 për pozitën Zyrtar Ligjor 1-katër pozita për Gjykatën Themelore në Ferizaj, në të cilin konkurs sipas regjistrimit të aplikacioneve të pranuar është dëshmuar se ka aplikuar edhe ankuesi, i cili është përfshirë në listën e shkurtër dhe ka marr pjesë në fazën e testimit me shkrim dhe me gojë, ndërsa pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka përgatitur renditjen përfundimtare të kandidatëve, ku ankuesi pas testit me shkrim dhe me gojë ka arritur gjithsejtë 333.25 pikë, kurse më datë 29.03.2022 është publikuar njoftimi për përzgjedhjen përfundimtare për katër pozita Zyrtar Ligjor në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në bazë të së cilës rezulton që ankuesi nuk është kandidat i përzgjedhur.

Ankuesi me datë 04.04.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ky i fundit më datë 19.04.2022 ka nxjerr Vendim KA.Nr.11/2022 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi Njoftimin e datës 29.03.2022 për kandidatët e suksesshëm.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.Nr.11/2022 të datës 19.04.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, pretendon se Komisioni Vlerësues duke mos përfillur kriteret bazike ka dështuar të nxjerr kandidatët më të mirë, ka keqpërdorur detyrën zyrtare dhe rrjedhimisht ka shkelur dispozitat ligjore për shërbyesit civil.

Kolegji i Këshillit, duke ju referuar konkursit të datës 16.12.2021 të shpallur për pozitën Zyrtar Ligjor I-katër pozita në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ka gjetur se kriteret për pozitën përkatëse të punës kanë qenë të përcaktuar, si: *Diplomë universitare, Fakulteti Juridik; dhe Një vit përvojë pune profesionale.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Komisioni Vlerësues ka dështuar të nxjerr kandidatët më të mirë duke mos përfillur kriteret bazike dhe duke shkelur kandidatët e tjerë, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar dosjen e lëndës dhe rrjedhimisht ka konstatuar se sipas dokumentacionit të aplikimit ankuesi posedon Diplomën me numër:1011-3322/1 të datës 01.11.2017 me të cilën dëshmohet se i njëjti i ka përfunduar studimet Master në Fakultetin Juridik të Universitetit të Evropës Juglindore-Tetovë, diplomë e cila është nostrifikuar përmes vendimit të datës 20.03.2018 me numër Ref.Nr.6-1680 të nxjerrë nga Kryesuesja e Këshillit Shtetëror për njohje në kuadër të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. I njëjti po ashtu posedon Diplomën e datës 22.04.2013 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik të Universitetit të Evropës Juglindore-Tetovë, diplomë e cila është nostrifikuar përmes vendimit të datës 20.06.2014 me numër Nr.61054 të nxjerrë nga Kryesuesi i Këshillit Shtetëror për Njohje dhe Sekretari i Përgjithshëm në kuadër të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Ndërsa sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës së punës është konstatuar se ankuesi posedon Certifikatën me shifër GJ.A.Nr.144/2019 e datës 01.04.2019 me të cilën dëshmohet se ka kryes stazhin e praktikës në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega Shtërpcë nga data 01.04.2018 deri më datë 31.03.2019, posedon kontratën e punës të datës 01.08.2019 përmes të cilit dëshmohet se i njëjti ka qenë i punësuar në biznesin individual "Avokatia-Avoka" në pozitën Bashkëpunëtor profesional nga data 01.08.2019 deri me datë 31.08.2020. Ndërsa, kandidati i përzgjedhur posedon Diplomën me Nr.1665/19 të datës 21.09.2019 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore në Kolegjin AAB në programin Juridik, posedon Certifikatën e datës 02.06.2021 për kryerjen e praktikës gjyqësore nga data 03.06.2020 deri më datë 02.06.2021 në Gjykatën Themelore në Ferizaj, kandidata e përzgjedhur posedon Diplomën me Nr.908/19 të datës 03.07.2019 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore në Kolegjin AAB në programin Juridik, posedon Certifikatën e datës 29.04.2021 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar praktiken gjyqësore nga data 26.02.2020 deri më datë 25.02.2021 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kandidati i përzgjedhur posedon Diplomën me Nr.4387 të datës 19.12.2016 ku ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, posedon Vërtetimin e datës 03.09.2019 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar kryerjen e praktikës gjyqësore nga data 03.09.2018 deri më datë 02.09.2019 në Gjykatën Themelore në Ferizaj, dhe Vërtetimin e datës 30.11.2020 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar kryerjen e praktikës gjyqësore nga data 01.06.2020 deri më datë 30.11.2020 në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe kandidata e përzgjedhur posedo Diplomën me Nr.775/18 të datës 20.07.2018 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore në Kolegjin AAB në programin Juridik, posedon Certifikatën e datës 31.02.2020 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar praktikën gjyqësore prej datës 01.04.2019 deri më datë 31.03.2020 në Gjykatën Themelore në Ferizaj, posedon Kontratën e punës për kohë të pacaktuar të datës 06.07.2020 me të cilën dëshmohet se nga data 06.07.2020 deri më datë 01.03.2021 ka qenë në marrëdhënie pune në VIA SHPK në pozitën Juriste.

Kolegji i Këshillit nga vlerësimi i dokumentacionit të aplikimit ka gjatuar se ankuesi dhe kandidatët e përzgjedhur kanë plotësuar kushtet e arsimit dhe përvojës së punës të kërkuar me konkurs, dhe mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në mënyrë të drejtë ka vlerësuar aplikacionet e ankuesit dhe

kandidatëve të përzgjedhur, duke vepruar në pajtim me 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë:1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional; si dhe 1.2. përvoja e punës"*, andaj në këtë aspekt nuk ka pasur asnjë lloj diskriminimi ndërmjet kandidatëve të përzgjedhur dhe ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi në testin me shkrim ka arritur (61.5) pikë, andaj me rastin e ftesës për intervistim me gojë Komisioni Përzgjedhë ka vepruar në pajtim me nenin 36 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *"Kandidatët të cilët e kalojnë me sukses testimin me shkrim dhe arrijnë të mbledhin së paku 50 % të maksimumit të pikëve të përcaktuara nga KPSHC pranohen të hyjnë të testit me gojë...."*. Po ashtu, Kolegji gjatë analizimit të formularëve të datës 11.03.2021 në të cilët evidentohen pikët e testit me shkrim dhe formularët e vlerësimit të intervistës me gojë të datës 24.03.2022 është konstatuar se ankuesi është vlerësuar nga të gjithë anëtarët edhe në fushën e kriterëve të përzgjedhjes siç janë: *"Personaliteti dhe Planet Profesionale; Njohuritë e Përgjithshme Institucionale dhe Ekonomike; Njohuritë që Lidhen me vendin e Punës"* siç përcaktohet edhe me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 38 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 se: *"Kandidatët të cilët kalojnë me sukses testimin me shkrim i nënshtrohen testimit me gojë, e cila përbehet prej këtyre pjesëve: 1.1 Personaliteti dhe Planet Profesionale; 1.2 Njohuritë e Përgjithshme Institucionale dhe Ekonomike dhe 1.3 Njohuritë që Lidhen me vendin e Punës"*, andaj mbi bazën e këtyre fakteve Komisioni Përzgjedhës ka kryer detyrat e përcaktuara në nenin 7 paragrafin 7 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ndërsa pretendimi ankimor i ankuesit se Komisioni Përzgjedhës nuk ka zbatuar dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Ligjit Nr.03-L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, pasi që nuk zbatuar parimin e meritës, është i pa bazuar.

Nga shqyrtimi i formularit të vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë të kandidatëve, respektivisht ankuesit, vërehet se ankuesi nga testi me shkrim dhe me gojë ka grumbullimi gjithsejtë 333.25 pikë, duke mos u renditur as në mesin e njëzetepesë (25) kandidatëve me të vlerësuar sipas listës përfundimtare të kandidatëve, ndërsa katër (4) kandidatët e suksesshëm, të cekur si më lartë, janë vlerësuar me më shumë pikë, respektivisht kandidati: ka arritur rezultat prej 458.25 pikësh, ka arritur rezultat prej 412.5 pikësh, ka arritur rezultat prej 404 pikësh dhe ka arritur rezultat prej 400 pikë, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të dispozitave të nenit 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, parashihet se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë"*, dhe si rrjedhojë pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara ngase Kolegji thekson se gjatë analizimit të shkresave nuk ka arrit të gjej ndonjë shkelje në procesin e vlerësimit të kandidatëve nga ana e Komisionit Përzgjedhës.

Andaj, mbi bazën e të gjeturave si më lart, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se procedura e rekrutimit për pozitën *"Zyrtar Ligjor 1 -në Gjykatën Themelore në Ferizaj-katër pozita"* e shpallur me konkursin e datës 16.12.2021 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.03-L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht neni 11 paragrafi 1 i cili përcakton se: *"Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të*

barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve” si dhe nenin 18 paragrafi 1 i të njëjtit ligji i cili përcakton se: “Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidateve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”, ndërsa ankesa e ankuesit është e pabazuar në tërësi dhe si e tillë është refuzuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, po ashtu, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA.nr.11/2022 të datës 19.04.2022 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe e ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.458/2022

Elatron GASHI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

